



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Në bazë të nenit 12.2 pika (d), 14, nenit 17, dhe nenit 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15, qershor 2008), nenit 3 paragrafi 1 dhe neni 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 569/1 i datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më datë 28 prill 2016 merr këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr.184 i datës 28.04.2016, për shlyerjen e 50% të borxhit të Qemajl Veselit, shfrytëzues i përkohshëm i hapësirës publike (barakës), në fshatin Krushë e Madhe.

Neni 2

Shlyerja e borxhit prej 50% bëhet për shkak që qiramarrësi aktualisht është në kushte të rënda ekonomike dhe nuk ka mundësi të siguroj mjete të mjaftueshme për pagesën e borxhit të vjetër.

Neni 3

Obligohet shfrytëzuesi i hapësirës publike (barakës), që të paguajë paraprakisht 50% të borxhit me qëllim të shlyerjes së pjesës së mbetur, në afat kohor 6 (gjashtë) muaj, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në të kundërtën i ndërpritet kontrata, si dhe borxhi kthehet në pikën fillestare.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Shërbime Publike.

01 Nr. 1418
Rahovec, 28.04.2016

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

